



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2024:070119

Datë: 27.06.2024

Numri i dokumentit: 05870771

**P.nr.487/24**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Bujar Ahmeti dhe bashkëpunëtorin profesional Bekim Telaku, në çështjen penale kundër të pandehurit K.K. nga fshati ..., Komuna e P., lagja e ..., për shkak të veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 367 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe veprës penale keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe ujit të shtazëve, nga neni 346 par. 2 pika 2.1 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/I.nr.964/24 të datës 11.03.2024, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit fillestar, publik, me datë 12.06.2024, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Kastriot Berisha, të pandehurit K.K. dhe mbrojtësit të tij av. F.K., me datë 13.06.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me datë 27.06.2024 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### *I pandehuri,*

**K.K.**, nga babai I. dhe nëna S., mbiemri i vajzërisë se nënës R., i lindur me datë ..., në P., me vendbanim në fshatin ..., lagja e ..., P., i martuar, baba i tre fëmijëve, punon, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i identifikuar me numër personal ...

## ËSHTË FAJTOR

### *Sepse:*

- I. Me datën 26.02.2024, rreth orës 15.30 në P. në lagjen K., i pandehuri K.K. me dashje dhe në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët apo materialet plasëse të tilla, ka përdorur armen zyrtare të tipit "Glok KPS -3134", të cilën e posedon nëna e tij zyrtarja policore S.K., e të cilën e kishte marr pa dijeninë e saj, në atë mënyrë që ditën kritike pasi që afër shtëpisë së tij ishin afruar disa qenë, i njëjti ka shtënë në drejtim të disa qeneve ku njërin nga ta e ka plagosur.
- Me këto veprime ka kryer veprën penale *përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së.*

II. Në kohën dhe vendin si në pikën 1 të këtij dispozitivi i pandehuri K.K., me dashje dhe me qëllim që ti shkaktoj lëndime trupore kafshës (qenit) pronë e të dëmtuarit K. E. M., ashtu që me veprim duke përdorur armen zyrtare të tipit “Glok KPS -3134” ka shtënë dhe e ka goditur me plumb, me çka ka i ka shkaktuar plage në trupin e tij.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale *keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe ujit te shtazëve nga neni 346 par.2 pika 2.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.*

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39 par. 1 pika 1.1 dhe 1.2, 43, 46 par. 1 pika 1.1, 47, 48, 69, 70, 76, 79, nenit 367 par. 1 dhe 346 par. 2 pika 2.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së, dhe nenit 242, 364, si dhe 449 të KPP-së, të pandehurit i:

### C A K T O N

Për veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, të përshkruar si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton:

- **DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 180 (njëqindetëdhjetë) ditë.

Në kuptim të nenit 44 par. 1 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të pandehurit, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë (180) ditë, i zëvendësohet në **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej dymijepesëqind euro (2.500 €).

Për veprën penale keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe ujit te shtazëve nga neni 346 par.2 pika 2.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, të përshkruar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, i shqipton:

- **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 500 € (pesëqind euro).

Në kuptim të nenit 76 par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-së, të pandehurin e:

### G J Y K O N

Me **DËNIM UNIK ME GJOBË** në shumë prej 3.000 € (tremijë euro), të cilin dënim obligohet ta paguaj në afat prej 2 (dy) muajsh dhe atë në dy këste mujore, pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par. 3 të KPRK-së, ashtu që dënimi me gjobë do të zëvendësohet me dënim me burgim, ku një ditë burgim do të llogaritet me 20 € (njëzet euro) të gjobës.

Në kuptim të nenit 113 të KPP-së **URDHËROHET** kthimi i sendeve të sekuestruara përkohësisht, dhe atë i armës zyrtare të tipit “Glok KPS -3134”. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo armë i kthehet Policisë së Kosovës.

E dëmtuara K. E. M. për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

I pandehuri obligohet që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 € (njëzet euro) dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

### *Rrjedha e procedurës penale*

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj me numër PP/I.nr.964/24 të datës 11.03.2024 të pandehurin K.K. e ka akuzuar për shkak të veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm, nga neni 367 par.1 të KPRK-së, dhe veprës penale keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe ujit të shtazëve, nga neni 346 par. 2 pika 2.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të kompetencës lëndore dhe territoriale dhe duke vepruar sipas aktakuzës, me datë 12.06.2024 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin seancë të shqyrtimit prezent ishin Prokurori i Shtetit Kastriot Berisha, i pandehuri K.K. dhe mbrojtësi i tij av. F.K. i angazhuar sipas autorizimit.

Gjyqtari i vetëm gjykues në seancën e shqyrtimit fillestar e ka udhëzuar të pandehurin për të drejtat konform nenit 241 par. 1 të KPP-së. Pas kësaj, Prokurori i Shtetit e ka lexuar aktakuzën dhe pasi gjyqtari u bind se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, bazuar në dispozitën e nenit 241 par. 4 të KPP-së të njëjtit i ofroi mundësinë që të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm.

Në seancën e shqyrtimit fillestar i pandehuri pas sqarimeve të nevojshme nga ana e gjykatës dhe në prezencën e mbrojtësit të tij, deklaroi se e pranoi fajësinë për veprat penale për të cilat e ngarkon aktakuza, se është i vetëdijshëm për pranimin e fajësisë dhe pasojat e këtij pranimi, duke shtuar se i vjen keq për rastin që ka ndodhur, nuk ka pasur qëllim që të godas qenin apo ndonjë veprim tjetër, mirëpo nga frika për fëmijët që kanë qenë në oborr ka vepruar në këtë mënyrë, njëherit ka deklaruar se është i gatshëm që t'ia kompensoj çfarëdo lloj dëmi të dëmtuarit, pasi që nuk ka pasur qëllim të dëmtoj qenin e të dëmtuarit.

Pasi që i pandehuri në seancën e shqyrtimit fillestar e ka pranuar fajësinë, konform nenin 242 par. 5 të KPP-së gjyqtari ka kërkuar mendimin e palëve prezentë, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Mbrojtësi i të pandehurit ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij dhe i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj pranimin e fajësisë, pasi që pranimi si i tillë është bërë pas konsultimeve të mjaftueshme, me vullnet të plotë dhe pa presion. Ndërkaq, sa i përket rrethanave për caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ka propozuar që gjatë matjes së dënimit gjykata të ketë parasysh pranimin e fajësisë qysh në fazën fillestare, pendimin si dhe bashkëpunimin me organet e policisë. Ka shtuar se bashkëpunimi duhet të merret si rrethanë tepër lehtësuese për faktin se organet e policisë nuk kanë pasur informacion se kush e ka përdorur armën, e këtë përdorim të armës i pandehuri vullnetarisht e paraqet në organet e policisë, rrethanë tjetër lehtësuese gjykata të ketë parasysh se kjo veprë është kryer në oborrin e shtëpisë së të pandehurit ku ka qenë duke luajtur bashkë me fëmijët dhe për një moment një grumbull qenesh endacak dhe

pa pronar kanë hyrë në oborrin shtëpisë së tij. I dëmtuari nuk ka qenë afër atij lokacioni, andaj mbi këto rrethana i ka propozuar gjykatës që të pandehurit t'i shqiptoj dënim të kushtëzuar.

Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit pasi që është në pajtim të plotë me nenin 242 të KPPRK-së, dhe po ashtu mbetet në tërësi pran aktakuzës, ka konsideruar se pranimi i fajësisë është mbështetur në provat materiale, prova këto të cilat gjendet në shkresat e lëndës, njëherit pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kurrfarë presioni. Bazuar në këto prova prokurori i shtetit ka propozuar që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin të merret pranimi i fajësisë dhe fakti se i pandehuri më parë nuk ka qenë i gjykuar, ndërsa si rrethanë rënduese ka propozuar që të merret parasysh fakti se i njëjti ka shkelur besimin e nënës së tij e cila është zyrtare policore, ashtu që ka marr armën të cilën e njëjta e kishte lënë në shtëpi.

#### *Vlerësimi i gjykatës lidhur me pranimin e fajësisë.*

Gjykata, ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilën e ka deklaruar i pandehuri dhe erdhi në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë në pajtim me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-së dhe në pajtim me faktet dhe provat që përmban aktakuza, njëherit vlerësoi se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe mbështetet në faktet dhe provat materiale të rastit konkret të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime faktike, dhe po ashtu gjykata sipas detyrës zyrtare dhe konform nenit 251 të KPP-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme. Pasi gjyqtari i vetëm gjykues u bind se i pandehuri e ka kuptuar natyrën, benefitet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, si dhe pasi që konstatoi se pranimi është në përputhje me nenin 242 paragrafi 2 të KPP-së, me aktvendim e aprovoi pranimin e fajësisë së të pandehurit, për veprën penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së dhe veprën penale keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe ujit të shtazëve nga neni 346 par.2 pika 2.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Me qenë se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen në barrë, e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave në këtë çështje penale, por shqyrtimi fillestar ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

#### *Gjendja faktike e vërtetuar.*

Gjykata, nga pranimi i fajësisë se të pandehurit dhe nga provat të cilat i janë bashkangjitur shkresave të lëndës, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të pandehurit formohen të gjitha elementet e veprës penale përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm nga neni 367 par. 1 të KPRK-së, të përshkruar sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me burgim prej një (1) deri në tetë (8) vjet, dhe veprës penale keqtrajtimi i kafshëve dhe ndotja e ushqimit dhe ujit të shtazëve nga neni 346 par.2 pika 2.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, të përshkruar sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë (6) muaj, për dhe për këtë gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqiptoj dënimin unik

me gjobë, më afër të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësinë e tij penale juridike.

*Rrethanat me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit.*

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69, 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethana lehtësuese gjykata vlerësoi faktin e pranimit të fajësisë në këtë fazë të procedurës nga i pandehuri për veprën penale për të cilën akuzohet, pendimi për kryerjen e veprës penale, keqardhjen e shfaqur nga i njëjti për rastin e ndodhur, kërkim faljen ndaj palës së dëmtuar, gatishmërinë që të kompensoj palën e dëmtuar, bashkëpunimin e tij me gjykatën, sjelljen e tij pas kryerjes së veprave penale, faktin se i njëjti më parë nuk ka qenë i dënuar, si dhe premtimi se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori për bazë shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, rrezikshmërinë shoqërore të këtyre veprave penale, si dhe faktin se i pandehuri ka shkelur besimin e nënës së tij e cila është zyrtare policore, ashtu që ka marr armën të cilën e njëjta e kishte lënë në shtëpi.

Gjykata duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret dhe në kuptim të nenit 71 par. 1 nën par. 1.1 dhe 1.2 lidhur me nenin 72 par. 1 nën par. 1.5 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptoj dënimin nën kufirin e paraparë ligjor dhe atë dënimin me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë ditë, pasi që konsideron se ekzistojnë rrethana posaçërisht lehtësuese të cilat e justifikojnë shqiptimin e një dënimi të tillë, si pranimi i fajësisë, sjelljen e tij pas kryerjes së veprave penale, në atë mënyrë që ngjarjen e paraqet vet vullnetarisht në gjykatë, kërkim faljen palës së dëmtuar dhe pendimin e tij për kryerjen e veprave penale dhe rrethana tjera.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të njëjtit i shqiptoj dënimin unik me gjobë më afër të përshkruar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ku në rastin konkret mori për bazë pranimin e fajësisë, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla apo të ngjashme dhe pendimin e shprehur për veprën e kryer penale. Gjykata me këtë dënim konsideron se i pandehuri e ka kuptuar rëndësinë e veprimeve të dëmshme dhe mbi bazën e këtyre rrethanave, gjyqtari është i bindur se dënimin unik me gjobë, është në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit, duke marrë parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë pranimin e fajësisë, kështu gjykata vlerëson se me shqiptimin e dënimit unik si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimin i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të kryesit, po ashtu ky dënim do të shërbej në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale), si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbaj edhe personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

*Vendimi mbi kthimin e sendeve.*

Vendimi për kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht të përshkruara sikurse në vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve me numër të rastit 2024-AC-0301 të datës 27.02.2024, gjykata e mori duke u bazuar në dispozitivin e nenit 113 të KPP-së, ngase ka gjetur se e njëjta armë është pronë e

Policisë së Kosovës dhe si e tillë e njëjta pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi duhet t'i kthehet të njëjtës.

*Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike.*

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së, ku i dëmtuari K. E. M, për realizmin e kërkesës pasurore juridike e udhëzoi në kontestin e rregullt juridiko civil.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale.*

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës penale, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-së, obligoi të pandehurin që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro). Po ashtu, konform nenit 36 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit Nr.08/L -109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro) në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.487/24 datë 27.06.2024

**Bashkë. profesional**

Bekim Telaku

---

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**

Bujar Ahmeti

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimin të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.